



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE  
KËSHILLI DREJTUES

V E N D I M

Nr. 32 datë 20.09.2019

**“MBI MIRATIMIN E RAPORTIT PËRMBLEDHËS TË KVO-SË, NJOFTIMIN E FITUESIT DHE BOTIMIN E FITUESIT, TË TENDERIT PUBLIK ME PROCEDURË TË HAPUR ME OBJEKT: “DHËNIA E TË DREJTAVE TË PËRDORIMIT NË BREZIN E FREKUENCAVE 800 MHz (790-862 MHz) SPEKTËR I PAALOKUAR”, REF. 1X10 MHz I ÇIFTUAR-800-2019”**

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), me pjesëmarrjen e:

Z.	Ilir	Zela	Kryetar
Znj.	Ketrin	Topçiu	Anëtare
Znj.	Edlira	Dvorani	Anëtare
Znj.	Xhoana	Lilaj	Anëtare

dhe sekretare Hasime Ferati, në mbledhjen e datës 20.09.2019, sipas procedurës së përcaktuar në Ligjin nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe Rregullores së Brendshme të Funkcionimit të Këshillit Drejtues të AKEP, miratuar me Vendimin nr.7 datë 16.02.2017 të Këshillit Drejtues të AKEP, shqyrtoi çështjen me objekt:

- *Miratimin e raportit përmbledhës të KVO-së, Njoftimin e Fituesit dhe Botimin e Fituesit, të tenderit publik me procedurë të hapur me objekt: “Dhënia e të drejtave të përdorimit në brezin e frekuencave 800 MHz (792-862 MHz) spektër i paalokuar”, Ref. 1x10 MHz i çiftuar-800-2019.*

**BAZA LIGJORE:**

1. Ligji nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (**Ligji 9918/2008**);
2. VKM Nr. 1252, datë 10.09.2008, pika 19.1 “Për miratimin e rregullave të zhvillimit të tenderit publik për dhënien e së drejtës të përdorimit të frekuencave”, i ndryshuar (**VKM nr.1252**);
3. Ligji Nr.44/2015 “Kodi i procedurave administrative i RSH”, (**Ligji 44/2015**);

## KËSHILLI DREJTUES:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor si më poshtë:

- Raporti Përmbledhës i KVO-së për procedurën e tenderit publik, protokolluar me Nr. 688/98 Prot, datë 20.09.2019;
- Njoftimi i Fituesit sipas Shtojcës Nr. 18 - Formulari i Njoftimit të Fituesit;
- Botimi i Fituesit sipas Shtojcës Nr. 19 - Formulari i Botimit të Fituesit;
- Relacioni Shpjegues;
- Projektvendim i KD, i formatuar dhe arsyetuar;

Si dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

### VËREN:

#### 1. Dokumentacioni.

- a) Raporti përmbledhës i hartuar nga Komisioni i Vleresimit të Ofertave (KVO), është në përputhje me pikën 15.10, Kreu III të VKM Nr.1252, datë 10.09.2008 “Për miratimin e Rregullave të zhvillimit të tenderit publik për dhënien e së drejtës së përdorimit të frekuencave”, i ndryshuar;
- b) Shtojca 18 - Formulari i Njoftimit të Fituesit të Tenderit publik me procedurë të hapur me objekt: “*Dhënia e të drejtave të përdorimit në brezin e frekuencave 800 MHz (790-862 MHz) spektër i paalokuar*”, Ref. *1x10 MHz i çiftuar-800-2019*”, është përgatitur në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator përkatës dhe me Dokumentin e Tenderit.
- c) Shtojca 19 - Formulari i Botimit të Fituesit, është përgatitur në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator përkatës dhe me Dokumentin e Tenderit.

#### 2. Njësia e Hartimit të Dokumenteve ka parashtruar dokumentacionin përkatës për shqyrtim të çështjes sipas objektit, në përputhje me kërkesat proceduriale dhe ligjore të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.

#### 3. Dokumentacioni për miratimin e Raportit Përmbledhës të KVO-së dhe Njoftimin e Fituesve të Tenderit publik me procedurë të hapur me objekt: “*Dhënia e të drejtave të përdorimit në brezin e frekuencave 800 MHz (792-862 MHz)*”, Ref. *1x10 MHz i çiftuar-800-2018*”, është përgatitur në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator përkatës. KVO, ka kualifikuar shoqërinë Telekom Albania sh.a, për 1 (një) të drejtë përdorimi - Bllokun A3 të frekuencave të brezit 800 MHz - (811-821 MHz) i çiftuar me (852-862 MHz), me vlerë të ofertës 7 441 000 (shtatë milionë e katërqind e dyzet e një mijë) Euro.

## PËR KËTO ARSYE:

### Duke marrë në konsideratë:

- VKM Nr. 1252, datë 10.09.2008, “Për miratimin e Rregullave të zhvillimit të tenderit publik për dhënien e së drejtës të përdorimit të frekuencave”, i ndryshuar, pika 1.3 dhe pikën 19.1;
- Dokumentin e Tenderit;
- Raportin Përmbledhës të KVO-së për zhvillimin e procedurës së tenderit publik protokolluar me nr. 688/98 prot. i AKEP datë 20.09.2019;

dhe në zbatim të nenit 114 dhe nenit 115 të Ligjit nr. 9918/2008, Këshilli Drejtues i AKEP,

### VENDOSI:

1. Të miratojë Raportin Përmbledhës të KVO-së me nr. 688/98 prot. i AKEP datë 20.09.2019, sipas dokumentit bashkëlidhur;
2. Të miratojë Njoftimin e Fituesit shoqëria Telekom Albania sh.a, për bllokun A3 të frekuencave të brezit 800 MHz - (811-821 MHz) i çiftuar me (852-862 MHz), sipas dokumentit bashkëlidhur (shtojca 18);
3. Të miratojë Botimin e Fituesit shoqëria Telekom Albania sh.a, për bllokun A3 të frekuencave të brezit 800 MHz - (811-821 MHz) i çiftuar me (852-862 MHz), sipas dokumentit bashkëlidhur (shtojca 19);
4. Ngarkohet Njësia e Hartimit të Dokumenteve për dërgimin e njoftimit fituesit dhe të bëhet publikimi i botimit të fituesit në faqen zyrtare të internetit të AKEP, [www.akep.al](http://www.akep.al).

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR**

**ANËTAR**

**ANËTAR**

**ANËTAR**

**Ilir Zela**

**Ketrin Topçiu**

**Edlira Dvorani**

**Xhoana Lilaj**